

Nje Shqiperi plot grinte humbet kunder Zvicres

nga Administrator

E martë, 14 Qershor 2016 13:41



Kombetarja jone ka humbur ne ndeshjen e pare te Europeanit France 2016. Lojtaret kane hyre ne fushe me shume emocione dhe si rrjedhoje jane ndeshkuar qe ne minuten e 5 te lojes. Nje dalje e gabuar e portierit Berisha i ka dhene mundesine mbrojtetit helvet Schar te shenoje. Shqiperia eshte shokuar nga ky gol i shpejt dhe per 25 minutat e para ka vuajtur lojen e zviceraneve te cilet kane kercenuar disa here porten e Berishes.

Ne minuten e 23, kapiteni i kombetares Cana ka marre nje karton te verdh krehj te panevojshem i cili do te rezultojte deçiziv me vone.

Ne minuten e 31 sulmuese Sadiku merr nje top te bukur nga Hysaj, i vetem perballe portierit Sommer nuk arrin te shenoje. Nje rast i arte per Shqiperine per te barazuar rezultatin. Ne minuten e 36, kapiteni Cana nuk arrin te ndal sic duhet sulmuesin Seferovic, dhe shkakton faull duke prekur topin me dore, per arbitrin nuk ka dyshime dhe vjen kartoni i dyte i verdhe qe shnderohen ne te kuq. Shqiperia eshte e detyruar te luaje me 10 futbolliste. Zvicra shton presionin por pa arritur te shenoje golin e dyte.

Pjesa e dyte nis pa zevendesime, Kukeli spostohen ne qender te mbrojtjes ne rolin e Canes. Shqiperia me mbeshljen e me shume se sa 25 mije tifozeve shqiptare fillon e te reagoje ne kerkim te golit te barazimit. Ne minuten e 51 eshte serish Sadiku qe nuk zoteron sic duhet nje top te dhene nga Hysaj. Zviceranet administrojne lojen dhe me ane te kundersizimit kerkojne golin e qetesise por do te jete portieri Berisha qe do te shpetojte porten tone. De Biasi fut ne loje Kaçen per Xhaken dhe me pas edhe Cikalleshin ne vend te Roshit. Jane minuta te mira per Shqerine por Sadiku dhe Cikalleshi nuk arrijne te shfrytezojne rastet e mira per te barazuar rezultatin e ndeshjes. Ne minuten e 82 del nga loja Sadiku dhe ne vend te tij aktivizohet Gashi. Ne minuten e 88, Abrashi jep nje asist perfekt per Shkelzen Gashin, i cili i vetem me portierin Sommer nuk arrin te shenoje. Nje rast teper i volitshem per kombetaren tone qe nuk arrin te barazojte rezultatin. Ne minutat e fundit lojtaret e kombetares mundohen qe te gjejne golin e barazimit por pa ja arritur qellimit.

Ndeshja perfundon me rezultatin minimal 1-0, ke perseri jemi ndeshkuar nga nje gabim i minutave te para si edhe nga emocionet e medha.

Kapiteni Cana, ne nje fare menyre ka kompromentuar rezultatin e ndeshjes duke lene me 10 lojtare ekipin.

Nje ndeshje ku pergjithesisht ekipi ka luajtur mire dhe ka kerkuar me ngulm golin e barazimit por kjo nuk ka mjaftuar per te shmangur humbjen.

Ndeshja e rradhes e kombetares sone edhe ditën e merkure ne Marseje kunder Frances.